



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2017

EKSPERTIMET SI BURIM PROVE DHE EFEKTIVITETI I PËRDORIMIT TË TYRE NË PROCESIN PENAL

Fatmir Tartale

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University, Tiranë

Adresë kontakti: fatmirtartale@gmail.com

Përmbledhje

Ekspertimi si një nga provat që merren gjatë procedimit penal, përcaktohet nga organi i procedimit me anën e shtrimit, para ekspertit, të pyetjeve që duhet të zgjidhen mbi bazën e njohurive të tij të posaçme. Zgjidhja e këtyre pyetjeve realizohet nëpërmjet paraqitjes së materialit përkatës nga ana e prokurorit ose e gjykatës, studimi i të cilit i krijon mundësi ekspertit për të arritur në përfundimet përkatëse rreth një fakti ose rrethane të caktuar. Gjatë procedimit penal, për zbulimin dhe vërtetimin e fakteve të rëndësishme në një çështje penale, policia gjyqësore, prokurori dhe gjykata, kur u lind nevoja, thërrasin specialistë të fushave të ndryshme të shkencës, të teknikës e të kulturës për të kërkuar mendimin e tyre të kualifikuar. Objekt i ekspertimit mund të jetë: vendi ku ka ndodhur vepra penale; sendi mbi të cilin autori ka vepruar gjatë kryerjes së veprës penale; gjurmë të gjetura në këtë send apo mjet të kryerjes së veprës penale; gjurmë në qeniet e gjalla (njerëz apo kafshë, shpendë, etj., ndaj të cilave ka vepruar autori i veprës penale) që mund të jenë: gjurmë gjaku, pështymë, spermë, qime floku, lëkurë e pjesëve të ndryshme të trupit të autorit, apo tek autori i veprës penale, gjurmët që kanë mbetur nga viktimat ose nga personat ndaj të cilëve është kryer vepra penale, por që vërtetojnë praninë e autorit në veprën e kryer penale, e cila po hetohet nga organet e hetimit paraprak, ose po gjykohet nga gjykata. Duke parë larminë e jetës së njeriut, ekspertimet janë të shumëllojshme. Edhe nevojat e organeve të procedimit janë gjithashtu të shumëllojshme, prandaj në këtë punim do të trajtohen disa prej këtyre ekspertimeve që gjejnë përdorim në procedimin penal shqiptar, apo edhe në atë të shteteve të tjera evropiane e më gjerë.

Fjalë çelës: *ekspertim, gjykatë, prokurori, polici gjyqësore, provë.*

EXPERTISE CASES AS THE SOURCE OF EVIDENCE AND THE EFFECTIVENESS OF THEIR USE IN THE CRIMINAL PROCESS

Abstract

Expertise as one of the sources of evidence taken during the criminal proceeding is determined by the proceeding authority, though putting before the expert questions to be settled on the basis of his special knowledge. The settlement of these questions is realized

through the submission of the relevant material by the prosecutor or the court, examination of which enables the expert to come to the relevant conclusions about a particular fact or circumstance. During the criminal proceeding, the judicial police, the prosecutor and the court, for the purpose of detecting and verifying important facts of a certain criminal case, as necessary, call specialists from various fields of science, technology and culture to ask for their qualified opinion. The object of expertise may be: the place where the criminal offense has occurred; the item on which the author has acted while committing the criminal offense; traces found in this item or means of committing the criminal offense; traces of living beings (humans or animals, poultry, etc., to which the perpetrator has acted) that may be: traces of blood, saliva, semen, hairs, skin from different parts the author's body or to the perpetrator of the criminal offense –traces remained by the victims or the persons against whom the criminal offense has been committed, but which confirm the presence of the perpetrator in the criminal offense that is under investigation by the preliminary investigation bodies or is being tried by the court. Given the diversity of human life, cases of expertise are diverse and so are the needs of the prosecuting authorities as well. This paper will address some of them which will be found in the Albanian criminal proceeding, or even in that of the other European countries and beyond.

Kew words: *expertise, court, prosecutor, judicial police, evidence.*

Hyrje

Siç dihet, vepra penale mund të prekë marrëdhënie shoqërore nga me të ndryshmet në fusha të çfarëdoshme të jetës. Kjo kushtëzon mundësinë që ekspertimi të gjejë zbatim në çdo fushë të teknikës, të shkencës ose të kulturës. Praktika e procesit të të provuarit tregon se si lloje më të shpeshta paraqiten ekspertimet nga fusha e kriminalistikës, traseologjisë, toksikologjisë, mjekësisë ligjore, psikiatrisë, kimisë, biologjisë, kontabilitetit; nga fusha e transportit rrugor, hekurudhor, ajror dhe detar; ekspertime që lidhen me ndërtimin, zjarrin, arkitekturën, arkeologjinë, si dhe një shumëllojshmëri ekspertimesh që ndikohen nga zhvillimi dinamik i jetës dhe i veprave penale që kryhen nga autorët e tyre. Këto ekspertime kanë veçoritë e veta, por në pamundësi për t'u ndalur në përmbajtjen e tërë llojeve të ekspertimit, do të shohim mundësinë konkrete për zbulimin e provave nëpërmjet disa llojeve të ekspertimeve, siç janë ekspertimi traseologjik, ai i materialeve ngjitëse, mjeko-ligjor, ekspertimi i lëkurës së kokës së njeriut, ekzaminimi i ADN-së, ekspertimi odorologjik dhe identifikimi i personit në bazë të zërit.

Ekspertimi traseologjik

Mbledhja e provave me anën e ekspertimeve traseologjike, d. m. th. e ekspertimeve ku objekt ekzaminimi janë gjurmët e duarve, të këmbëve, të dhëmbëve, të materialeve ngjitëse, të armëve të ndryshme, të mjeteve të transportit, të çelësave të automjeteve etj., ka synuar: a) në identifikimin e personit (të sendit) që ka lënë gjurmën, dhe b) kur një gjë e tillë nuk është e mundur, në vërtetimin e saktë të këtyre ose atyre cilësive (veçorive) të atij personi (ose sendi); c) në vërtetimin e shkaqeve dhe të kushteve në të cilat u krijuan gjurmët dhe, duke u nisur nga këto, njohjen e disa hollësive lidhur me ngjarjen që është duke u hetuar; d) në zbulimin dhe fiksimin e vetë gjurmëve në rastet kur kjo nuk është e mundur të bëhet pa një analizë laboratorike. Për rëndësinë që merr ekspertimi traseologjik për të gjitha këto drejtime, mund të sjellim shembuj nga praktika në lidhje

me vjedhjet e makinave, një vepër penale, e cila sot ndeshet shpesh. Kështu p.sh., gjatë këqyrjes së një makine Benz në datën 26. 05. 2004 të vjedhur në Tiranë, e cila ishte lënë në qytetin e Lezhës, u konstatua se gjatë realizimit të vjedhjes, në derën e anës së shoferit ishin lënë gjurmë të mjeteve dhe të pëllëmbës së dorës së majtë. Sipas rregullave procedurale, këto gjurmë u fiksuan dhe u bashkuan me çështjen. Një rast tjetër, në datën 27. 01. 2005 pranë lokal “Tajvanit”, ishte vjedhur përsëri një makinë tip Benz 300D. Me atë makinë u kapën në flagrancë A. P. dhe P. LL. Nga ekspertimi daktiloskopik që iu bë gjurmëve të lëna në makinë, doli se autori i vjedhjeve ishte P. LL. Në lidhje me këto çështje, organi i procedimit caktoi ekspertimin traseologjik dhe daktiloskopik. Me ndihmën e ekspertimit, pikësëpari vendosi të verifikojë hamendësimin nëse të dyja vjedhjet qenë kryer me të njëjtat mjete dhe nëse në të dyja makinat ishin lënë të njëjtat gjurmë. Për këtë qëllim, para ekspertit u shtrua pyetja nëse të dyja vjedhjet qenë kryer me të njëjtat mjete. Eksperti shfaqti mendimin se gjurmët ishin lënë nga i njëjti mjet, si në portën e makinës, ashtu dhe në bravën e çelësit të saj. Me ndihmën e ekspertimit daktiloskopik, organi i procedimit verifikoi nëse gjurmët e gishtave ishin lënë prej personave të ndaluar si të dyshimtë në kryerjen e këtyre veprave penale. Eksperti dha raportin kategorik që gjurmët e gishtave ishin lënë nga P. LL. (1). Këto të dhëna të mendimeve të ekspertëve, të pavarura nga njëra-tjetra, lejuan planifikimin e drejtë të hetimeve paraprake dhe në të njëjtën kohë, shërbyen si hallka të rëndësishme në tërësinë e provave të mbledhura në çështje, duke argumentuar në mënyrë plotë fajësinë e P. LL.-së dhe të bashkëpunëtorëve të tij në kryerjen e vjedhjeve.

Ekspertimi i materialeve ngjitëse

Në kushtet e sotme, institucionet e ekspertimit ligjor kanë vënë forcat për zgjerimin e mundësive të ekspertimit mbi bazën e integritet të njohurive speciale të tërheqjes në praktikë objekteve të reja, të ekspertimit kriminalistik të materialeve, të lëndëve dhe të produkteve me ngjitës. Vitet e fundit i është kushtuar vëmendje e veçantë përpunimit të bazave teorike dhe metodologjike të shumëllojshmërisë së ekspertimit kriminalistik të materialeve, substancave dhe produkteve të materialeve ngjitëse që dalin gjithnjë e më shumë në cilësinë e provave materiale gjatë hetimeve të veprave të ndryshme penale, si në ato kundër personit, në vrasjet, vjedhjet e pasurisë me dhunë, në vjedhje bankash, duke përdorur eksploziv; në shkeljet e rregullave të sigurimit teknik; në vjedhje të mjeteve të transportit, në aktet terroriste, etj. Ky lloj ekspertimi është i kushtëzuar me përhapjen e gjerë dhe përdorimin e materialeve ngjitëse në të gjitha degët e ekonomisë, si dhe në përdorimin e gjerë familjar.

Industria kimike prodhon shumë materiale ngjitëse dhe e dallon secilin produkt nga vetitë e veta. Sasia e ngjitësve të llojeve të ndryshme sa vjen e rritet. Kështu, materialet ngjitëse përdoren në prodhimin dhe montimin e transportit automobilistik dhe kudo, në industrinë e përpunimit të drurit dhe atë të lehtë, në ndërtim, në tregti, në sistemin postar, në mjekësi, në administratë, etj. Gjithashtu, përdoren për ngjitjen e materialeve të ndryshme: shiritave të filmave, shiritave magnetikë; përdoren për paketimin e mallrave industriale dhe të ushqimeve, për pakot postare, në reklama, etj. Përhapja dhe shumëllojshmëria e materialeve ngjitëse përcaktojnë mundësinë më të madhe të gjurmëve të tyre, të shtresëzimeve, të mikrogjurmëve të veçanta në vendin e ngjarjes, në trupin (në veshjen) e të pandehurit ose të dëmtuarit në elemente të ndryshme të mjedisit të krimit. Objektet e ekspertimit mund të jenë: gjurmë, shtresëzime të materialeve ngjitëse të llojeve të ndryshme, të objekteve mbartëse; gjurme dhe shtresëzime të ngjitësve, në objektet që janë mjete të krimit; grimca (thërrmija) të materialeve ngjitëse që janë zbuluar në vendin e ngjarjes;

vëllime të përcaktuara të ngjitësve; madhësi të veçanta të komponentëve të materialeve ngjitëse (tretës, plastifikues, etj.); materiale të forta të përcaktuara në formën e kokrrizave, të rrathëve, të pllakave, të shtresës së hollë (ose të shiritit), të fijeve, etj.; shirita (filma) viskozë.

Objekte të këtij ekspertimi mund të jenë edhe: mjetet e transportit, elementet e konstruksioneve të ndërtesave dhe të pajisjeve, objekte të tjera, që nga përmasat e mëdha, nuk mund të merren dhe të bashkëngjiten me çështjen në cilësinë e provave materiale, por fotografohen e filmohen dhe më pas çdo gjë fiksohet në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes apo të faktit të fiksuar në këto objekte, që ka lidhje me veprën e kryer penale. Vetitë e bashkimeve me ngjitës varen nga shumë rrethana, siç mund të jenë: përgatitja e sipërfaqes së objekteve që ngjiten, numri i shtresave ngjitëse në secilën sipërfaqe të ngjitur, mënyrat e shtrimit të ngjitësve, shndërrimi i lëndës ngjitëse në shtresë, etj. Vetitë e bashkimeve (vendit ku ngjiten) u nënshtrohen ndryshimeve në varësi nga koha dhe kushtet kur është kryer ai; kohës së gjatë të veprimit të faktorëve të ndryshëm, si: ngarkesat, uljet e ngritjet e temperaturave, kushtet klimaterike, etj. Në bazë të metodave të studimit të materialeve të lëndëve dhe produkteve ngjitëse për zbulimin e gjurmëve në to, përdoren metodika kimike, spektrale, lumineshente, mikroskopike, kromatografike, si dhe metoda të tjera të studimit të ngjitësve. Eksperienca e fituar e kryerjes së ekspertimeve kriminalistike, thekson mundësinë parimore të përdorimit të fakteve që formojnë vetitë (cilësitë) e materialeve ngjitëse dhe të bashkimeve të ngjitjeve, në drejtim të zgjidhjes së detyrave që i janë ngarkuar ekspertit kur ekzaminon materiale të tilla ngjitëse apo objekte ku ato janë ngjitur e përdorur nga autorët e veprave penale. Lokalizimi i objekteve të zbuluara gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes me gjurmët-shtresa të ngjitësve, të lejon të sqarosh mekanizmin e formimit të këtyre gjurmëve, vendosjen e tyre, drejtimin dhe veprimin reciprok. Shtresëzimet e materialeve ngjitëse në veshjet e mjeteve të përdorura për thyerje dhe të sendeve të tjera mund të dëshmojnë për metodën e përdorur nga autorët e këtyre veprave penale, për mjetet e krimit dhe mënyrat e përdorimit të tyre. Llojet e materialeve ngjitëse që janë përdorur, sasia e shtresave, vazhdimësia e tyre, rregullsia, radha, mënyrat dhe teknologjia e vënies së ngjitësit, e përputhjes së tyre me standardet, etj. sjellin një informacion të rëndësishëm, dëshmuës të një fakti që mund të ketë rëndësi për zbulimin e së vërtetës në një procedim penal. Me mjaft rëndësi është edhe konstatimi i faktit të ringjitjes së mallrave të paketuara industriale, ushqimore, farmaceutike, të pakove postare, gjithashtu dhe konstatimi i burimit të prejardhjes së materialeve ngjitëse. Gjurmët-shtresëza të materialeve ngjitëse mund të kenë rëndësi të madhe në zgjidhjen e ekspertimeve komplekse të një çështjeje penale, në lidhje me faktet e bashkëpunimit të objekteve që janë paraqitur nga prokurori ose gjykata për ekzaminim. Me anën e ngjitësve bashkohen me njëri-tjetrin objekte të tjera, objekte zbukuruese, materiale fibroze dhe produkte të tyre (plastmasë, gomë, xham, metale, aliazhe dhe produktet e tyre), materiale ndërtimi, etj. Ngjitësit janë komponentë përbërës të një sërë materialesh, lëndësh dhe produktesh (të ngjyrave ngjitëse, të lëkurës artificiale, të materialeve me push artificial).

Sot ky lloj ekspertimi zgjidh një rreth të madh çështjesh, ndër të tjera: – Materiali i paraqitur për ekzaminim, a është material ngjitës? – Në objektet mbartëse a ka pjesëza ose gjurmë-shtresë të lëndës ngjitëse? – Për ngjitje a është përdorur një apo disa ngjitës? – Cila është natyra, pamja dhe emërtimi i materialit ngjitës? – Cili është mekanizmi i formimit të gjurmëve-shtresa të lëndës ngjitëse? – Materialet e krahasuara ngjitëse a kanë një grup të përbashkët përkatësie? – A janë të nevojshme? – A është përdorur ngjitësi i paraqitur për studim në përgatitjen e sendit? – Objektet e krahasuara a kanë të njëjtin burim të prejardhjes nga teknologjia e përgatitjes së materialit ngjitës, të bashkimit ngjitës etj. ? – Objektet e krahasuara a i përkasin të njëjtës parti të produktit të uzinës

prodhuese konkrete? – Me mënyrë të fabrikuar apo artizanale është hedhur ngjitësi në objekt? – Në vartësi nga rrethanat e çështjes penale, para ekspertëve mund të parashtrihen dhe pyetje të tjera si: – A i janë nënshtruar hapjes dhe ngjitjes së përsëritur pakot postare apo pako të tjera? – Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në materialet ngjitëse që janë të kushtëzuara nga kushtet, nga paketimi, dërgimi dhe dorëzimi i sendit të paketuar? Etj.

Në çdo rast, në hetimin paraprak nevojitet të merren masa për zbulimin dhe ekzaminimin e materialeve ngjitëse që i përkasin çështjes. Mbi bazën e analizës së situatës në vendin e ngjarjes, e marrjes parasysh të veçorive të materialeve ngjitëse dhe kushteve të përdorimit të tyre, prokurori ose gjykata mund të marrë vendim për ekspertimin e objekteve bartëse, ku mund të zbulohen gjurmë-shtresëzime të ngjitësit. Natyrisht këtu bëjnë përjashtim rastet kur sendi bartës i gjurmës së ngjitësit nuk mund të veçohet nga vendi i ngjarjes dhe kur ka rrezik të humbasë mikroobjekti ose të ndodhin ndryshime gjatë transportit të tij, së bashku me objektin bartës. Pavarësisht nga përjashtimet e sipërme, për ekzaminim merren thërrmija apo pjesëza a objekte me shtresëzimet e lëndës. Për ta realizuar këtë, duhet të merren masa që garantojnë ruajtjen e pamjes fillestare dhe gjendjen e objekteve. Pjesëzat e marra paketohen dhe i vihen në dispozicion ekspertit që t'i ekzaminojë dhe ai përdor metodat traseologjike të ekzaminimit për të konstatuar nëse pjesëzat i përkasin një të tërë apo jo. Kushti kryesor i kryerjes së ekspertimit është paraqitja e mostrave për studimin krahasues, gjithashtu edhe paraqitja e të gjitha materialeve të çështjes, që përmbajnë të dhëna të cilat mund ta ndihmojë ekspertin në zgjedhjen e mjeteve, për t'i zbërthyer pyetjet që i ka vënë përpara prokurori apo gjykata.

Rezultati i ekspertimit varet edhe nga zgjedhja që u bën organi i hetimit paraprak materialeve të cilat i përkasin prejardhjes së objekteve që i nënshtrohen ekspertimit. Rëndësinë e këtij ekspertimi mund ta ilustrojmë me një shembull nga praktika. Kështu, në datë 10. 10. 2002 në Durrës pranë lokalit “Torra” ndodhi një konfrontim me armë. Ekspertët shkuan në lokal, ku në cilësinë e provës morën dy shishe birre të mbetura në tryezë dhe katër gjurmë papilare (me anën e gjurmëkopjuesit transparent). Këto gjurmë u emërtuan: «A», «B», «C», «D». Më vonë, në afërsi të shkollës së muzikës u gjet një makinë tip Fiesta, në të cilën në pjesën e brendshme të xhamit, nga krahu i shoferit, u gjet një gjurmë gishti (edhe ajo u mor me gjurmëkopjues). Kjo gjurmë u emërtua «E». Veprimet u kryen nga eksperti i Durrësit, i cili bëri mbylljen e gjurmëkopjuesve dhe shënimet e duhura në çdonjërin prej tyre. Vendimi i ekspertimit, bashkëngjitur dhe me pesë gjurmëkopjuesit, u dorëzuan në Institutin e Policisë Shkencore pranë Ministrisë së Brendshme. Shefi përkatës, në datën 03. 10. 2002, ngarkoi një ekspert dhe ia dorëzoi laborantit që i fotografoi të pesë gjurmëkopjuesit menjëherë. Eksperti, duke kryer ekspertimin daktiloskopik nr. 2855, datë 07. 10. 2002, arriti në konkluzionin se të pesë gjurmët e sjella për ekspertim, qenë të vlefshme për identifikim. Më 08. 10. 2002 akti i ekspertimit dhe pesë gjurmëkopjuesit u tërhoqën nga drejtuesi i laboratorit kriminalistik të Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Durrësit (2). Eksperti i këtij laboratorit krahasoi gjurmëkopjuesin “E” me atë që ndodhej në laboratorin kriminalistik të Durrësit (sipas tyre, e kishin marrë dy herë atë gjurmë dhe e kishin emërtuar “E I”) dhe vuri re se gjurma nuk ishte e njëjtë me atë të ekzaminuar, të quajtur «E». (Këtë gjurmë, “E”, dhe dy nga gjurmët e tjera: “A” e “C”, i kishin marrë nga dy herë, pasi cilësia nuk ishte e mirë, madje gjurmën e dytë “E” e kishin emërtuar “E I”. Por në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes nuk ishte shënuar se këto gjurmë qenë marrë dy herë (3). Nga tërësia e rrethanave të ngjarjes, u ngritën dyshime se gjurma që ndërruar duke u hapur nga eksperti kriminalist IPSh-së në Tiranë dhe duke vendosur gjurmë tjetër në vend të saj. Ndaj ekspertit filloi procedimi penal

nën e akuzën e veprave penale: shpërdorim detyre dhe kryerje e veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës, të parashikuara si vepra penale nga neni 248 dhe 301 të Kodit Penal (4). Sipas kërkesës së mbrojtësit të ekspertit të akuzuar nga ana e organit procedues, u vendos kryerja e ekspertimit teknik e grafik të gjashtë gjurmëkopjuesve nga ana e një grupi ekspertësh (tre prej një zyrë private ekspertimi, një nga Shoqata e Shkencave Ligjore dhe dy ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore pranë Ministrisë së Brendshme). Ekspertëve iu shtruan për zgjidhje dy pyetje: a) Shkrimi dhe nënshkrimi në gjurmëkopjuesit e emërtuar: “A”, “B”, “C”, “D”, “E” dhe “E l” a është kryer nga i njëjti person? b) Në gjashtë gjurmëkopjuesit objekt ekspertimi, a vërehen ndërhyrje në pjesët e prera të gjurmëkopjuesit (hapje dhe rimbyllje të gjurmëkopjuesit) dhe në nënshkrimin e vendosur në pjesët e tyre anësore? Ekspertët, me aktin e ekspertimit nr. 3372, datë 10. 11. 2002, arritën në konkluzionin se tekstet (shkrimet) në gjashtë gjurmëkopjuesit («A», “B”, “C”, “D”, “E” edhe “El”) objekte të këtij ekspertimi qenë shkruar nga e njëjta dorë; nënshkrimet (firmat) në ato gjashtë gjurmëkopjues duhet të qenë shkruar nga e njëjta dorë dhe te të gjashtë gjurmëkopjuesit objekt ekspertimi nuk u konstatuan gjurmë të ndërhyrjes, në pjesët e prera (hapje dhe rimbyllje të gjurmëkopjuesve), as te nënshkrimet e vendosura në pjesët e tyre anësore. Kryerja e këtij ekspertimi solli fakte që tregonin se eksperti i akuzuar nuk kishte kryer asnjë veprim të kundërligjshëm, dhe kështu ra poshtë çdo dyshim për akuzat e ngritura ndaj tij. Për rrjedhojë, u pushua procedimi penal (5).

Një ekspertim i tillë është me shumë rëndësi, pasi zbulon fakte që kanë vlerë provuese për veprën penale të ndodhur dhe për autorin që heton organi i hetimit paraprak, ose, kur nuk ekzistojnë fakte të tilla, sqarohet pafajësia e personit të vënë nën akuzë. Së fundi, ky ekspertim i shërbeu edhe gjykatës për dhënien e një vendimi të drejtë.

Ekspertimi mjeko-ligjor

Mundësia e mbledhjes së provave me anë të ekspertimit mjeko-ligjor është mjaft e shumëllojshme. Ky ekspertim kryhet në hetimin e veprave penale kundër jetës e shëndetit të personit, si dhe të provave materiale e biologjike. Me ndihmën e këtij ekspertimi, organi i procedimit ka mundësi të sigurojë të dhëna mbi kohën kur ka ndodhur një vdekje, të tregojë se në ç’pozicion i janë shkaktuar plagët të dëmtuarit, nëse kufoma është lëvizur ose jo pas vdekjes, të japë të dhëna mbi karakterin dhe mënyrën e shkaktimit të plagëve dhe shkaqeve të vdekjes. Ekspertimi mjeko-ligjor lejon të verifikohen shpjegimet e ndryshme që jepen nga ana e të pandehurit, nga i dëmtuari dhe dëshmitarët rreth zhvillimit të ngjarjes që është duke u hetuar, si dhe jep mundësi të përcaktohet shkalla e rrezikshmërisë së plagëve të shkaktuara, etj.

Në shumë raste bëhet e nevojshme kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore të karakterit biologjik. Kjo ndodh kur duhet përcaktuar lënda organike nga e cila është formuar një njollë, lloji i flokëve, grupi i gjakut, gjinia, etj. Me ndihmën e ekspertimit mjeko-ligjor mund të sqarohen rrethana që i përkasin anës objektive; mund të grumbullohen të dhëna mbi karakterin e ngjarjes, mbi zhvillimin e saj etj. Kështu, të marrim një rast nga praktika. I mituri B. C., tek rrinte në një lokal, provokohet nga dikush më i madh në moshë dhe fizikisht më i fortë (në këtë rast viktimë). Për të mos e vazhduar grindjen, B. C. del nga lokali, por provokuesi e ndjek, e fyen dhe e godet. I mituri, duke qenë nën goditjet e viktimës dhe i tronditur shumë edhe nga fyerjet drejtuar familjarëve të tij, nxjerr një thikë që kishte me vete dhe e godet një herë në trup. Personi (viktimë) vdes. Nga ekspertimi mjeko-ligjor i caktuar rezultoi se të dy kishin dëmtime në trup, ndërsa viktimë kishte dhe një goditje me thikë në bark. Mbi bazën e konkluzioneve të ekspertimit doli

që vdekja e viktimës kishte ardhur si rezultat i goditjes me thikë në bark nga ana e të miturit B. C. Nga provat e tjera të mbledhura gjatë hetimit paraprak, u sqaruan elementet e anës objektive, si dhe elementet e anës subjektive, dhe i mituri u gjykua dhe u dënua për veprën penale të vrasjes, të kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike, që parashikohet si vepër penale nga neni 82 i Kodit Penal (6).

Ekzaminimi i ADN-së

Ekzaminimi i ADN-së përbën një provë që për nga rëndësia, është e njëjtë me gjurmët daktiloskopike. Ky lloj ekspertimi shërben për identifikimin e autorit të kryerjes së veprës penale ose për përjashtimin e tij nga akuza, në bazë të gjurmës gjenetike të ashtuquajtura metoda të ADN-së (A = acidi, D = dezoxi, N = nukleini). ADN-ja ndodhet në çdo qelizë njerëzore, të kafshës dhe të bimës. Çdo qelizë e organizimit ka një kod, i cili quhet gjen. Metoda e përcaktimit të kodit gjenetik u aplikuan fillimisht në Angli, nga biologu anglez Alec Jeffery i Universitetit të Losterit në Angli më 1985. Ai vërtetoi se testi i AND-së bazohet në faktin se asnjë qenie njerëzore nuk ka trashëgimi të njëjtë gjenetike (7). Ai arriti në këto konkluzione, të cilat më pas u zhvilluan më tej duke u perfeksionuar dhe duke u përhapur në të gjithë botën, duke i vënë në shërbim këto metoda në hetimin paraprak dhe në gjykimin e veprave penale. Sot ka gjetur zbatim të gjerë dhe përdoret me efektivitet në shumë vende të botës (Europë, ShBA, sigurisht dhe në Shqipëri, etj.) në zbulimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale të vrasjeve, të marrëdhënieve seksuale me dhunë, të akteve terroriste, vjedhjeve me armë, kur gjatë kryerjes së veprës penale autorët janë përleshur me viktimat dhe kanë lënë gjurmë të tyre (gjak, sekrecione të ndryshme) në vendin e krimit. Në Shqipëri në analiza e AND-së për çështjet penale ka filluar të përdoret që prej vitit 1995. Këto analiza kryheshin në Policinë Shkencore të Romës. Ndërsa që prej vitit 2009, analiza e AND-së kryhet në Policinë tonë Shkencore (8).

ADN-ja ndodhet në gjak, në spermë, në sekrecionet vagjinale, në pështymë, në qimet e flokut, në grimca të muskujve dhe indeve organike që mbetën nga autorët e veprave penale, qofshin këto edhe të thara e të mbetura në objekte të ndryshme, madje edhe për disa vjet. Duke u zbuluar ADN-ja, është plotësisht e mundur të përcaktohet dhe të identifikohet personi që e ka atë ADN. Kjo realizohet duke e krahasuar me modelin e nxjerrë nga personi i dyshuar. Me anë të aparaturave bashkëkohore, analizohet përputhja apo mospërputhja e saj për një kohë të shkurtër. Eksperti i caktuar me autorizim të organit procedues në hetimin paraprak, apo nga gjykata në zbatim të kërkimeve të neneve: 151, 184, 198 e 199 të Kodit të Procedurës Penale (9), mund të marrë gjak apo të bëjë ndërhyrje të tjera trupore edhe pa vullnetin e personit (nëse nuk ka rrezik për jetën). Kur kemi njerëz të vdekur, veprimet kryhen në përputhje me kërkimet e nenit 200 të Kodit të Procedurës Penale (10), gjithmonë kur është e nevojshme për konstatimin e fakteve që kanë rëndësi për çështjen.

Ekspertimi odorologjik

Lindja e llojeve të reja të ekspertimeve ligjore, si një kërkesë e praktikës, e zgjeron rrethin e provave materiale dhe forcon depërtimin e të dhënave bashkëkohore, të shkencave natyrore dhe teknike në procedimin gjyqësor penal. Në këto metoda bën pjesë dhe odorologjia. "Cilësia më e rëndësishme e erës për odorologjinë kriminalistike është individualiteti i saj. Qysh në fundin e shekullit të kaluar, Hans Gros ka bërë me dije mundësinë e shfrytëzimit të qenve në hetime, duke theksuar se në këtë mënyrë zbulohet dhe përcillet më shpejt kriminel (11). Futja e ekspertimit ligjor

odorologjik në procedimin penal, jep ndihmesë në hetimin e veprave penale me rrezikshmëri të madhe. Kështu, në hetimin e procedimeve penale për vrasje, të marrëdhënieve seksuale me dhunë, në vjedhjet etj. Ky lloj ekspertimi mund të përdoret me efektivitet për identifikimin odorologjik të autorit të veprës penale, në bazë të gjurmëve të erës që ka lënë në vendin e ngjarjes.

Ky lloj identifikimi është aplikuar në vendin tonë që prej vitit 1950 (12), nëpërmjet përdorimit të qenit të stërvitur në këtë drejtim për zbulimin e autorëve të veprave penale, në bazë të gjurmëve të erës të lënë në objekte të ndryshme në vendin e ngjarjes. Natyrisht, për konservimin e erës që kanë lënë autorët, shërbejnë dhe laboratorë specifikë që konservojnë erërat e mbledhura në vendin e ngjarjes, të cilat më pas përdoren për zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave penale. Shkalla e përpikërisë së konkluzioneve të këtij ekspertimi është e barabartë me shkallën e rezultateve të llojeve më të përhapura të ekspertimeve ligjore, siç janë ekspertimet grafike apo daktiloskopike, etj. Në Hungari është krijuar Banka Shtetërore Qendrore e Erërave nga vendet e krimeve të pazbuluara, si dhe bankat e erës të rretheve dhe qarqeve. Në një vit në Hungari, me përdorimin e kësaj metode, zbulohen deri në 1000 krime (13).

Odorologjia përdoret edhe për kërkimin dhe zbulimin e drogave të fshehura në objekte të ndryshme dhe të eksplozivëve nëpërmjet qenit të stërvitur apo kafshëve të tjera të stërvitura posaçërisht. Duke iu referuar kërkimeve të nenit 198/1 të Kodit të Procedurës Penale që bën fjalë për këqyrjen (14), nuk ka ndonjë kufizim për zbulimin dhe marrjen e gjurmëve të zbuluara nga organi procedues. Në zbatim të kërkimeve të nenit 178 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi nuk ka parashikuar ndonjë kufizim (veç atij në paragrafin e dytë) kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave dhe e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore dhe kulturore (15). Pra, në këto raste nuk ka asnjë pengesë që të caktohet edhe ekspertimi ligjor odorologjik. Në këtë ekspertim, eksperti do të sqarojë disa çështje: – Nëse era në atë objekt bartës të erës (veshje, letër, armë, mjete të krimit, etj.) i përket personit që dyshohet apo jo; – Nëse, duke gjykuar në bazë të erës, njollat e gjakut në vendin e krimit, flokët, djersa, etj., i përkasin personit që dyshohet apo jo; – Nëse ruhen gjurmët e erës së këmbëve apo të duarve nga personi ose nga persona (kur janë disa) që dyshohen; – Cili nga të dyshuarit ka lënë erën në mjetet e thyerjes, në sipërfaqen e thyer, në drynin e thyer; – Kujt nga të dyshuarit i përket era në letër, në zarf, në dokument, në aparate të ndryshme apo pajisje të përdorura, sediljen e makinës, timonin e makinës, stilolapsin, portofolin, etj. – Nëse era në atë veshje është e personit të dyshuar apo jo; – Në cilën nga të gjitha teshat e paraqitura ka mbetur era e personit që paraqitet si i dyshuar.

Zbatimi i këtij ekspertimi dhe shfrytëzimi i konkluzioneve të tij nuk do të thotë që organi i procedimit të mbështetet vetëm në ato konkluzione për të akuzuar dhe dërguar për gjykim një person që dyshohet si autor i një veprë penale. Konkluzione të tilla mund të shikohen si prova indirekte dhe si bazë për veprimet e mëvonshme procedurale të organit të procedimit në procesin e të provuarit, për të vërtetuar më pas që në atë vepër penale ka marrë pjesë edhe një person, ndaj të cilit kanë filluar hetimet. Kjo do të shihet në raport me të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak, që organi i procedimit të arrijë në konkluzione përfundimtare në lidhje me autorin e dyshuar për kryerjen e një veprë penale të caktuar. Zbatimi i këtij ekspertimi do të ndihmojë në efektivitetin e luftës kundër kriminalitetit.

Identifikimi i personit në bazë të zërit

Studimi dhe krahasimi e individualizimi i zërit të njeriut, jo vetëm nëpërmjet shqisës së dëgjimit, vjen prej më shumë se 100 vitesh. Edhe ky lloj ekzaminimi është një ekspertim që ndeshet në

praktikë dhe është i mundur të realizohet, veçanërisht në hetimin e disa lloj veprash penale, siç janë: kanosje serioze për vrasje, njoftime për vënie bombe, telefonata me fjalë të ndyra, mesazhe kërcënuese ose shantazuese të lënë në sekretaritë telefonike, në vjedhje me dhunë, me armë; marrëdhënie seksuale me dhunë, rrëmbim ose mbajtje peng personi/personash, akte terroriste (të parashikuara si vepra penale nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë), në të cilat jo rrallë mbetet zëri i incizuar i personit të dyshuar, sidomos në shiritat magnetikë, në mjetet e sotme të komunikimit, me anën e të cilave transmetohet ose regjistrohet zëri, siç janë: sekretaritë telefonike, telefonat celularë apo mjete të tjera incizimi apo filmimi që njëkohësisht regjistrojnë figurën dhe zërin e personit që ka kryer veprën penale, pa përjashtuar edhe zërat e përfutur nga përgjimi i kryer në referim të kërkimeve të neneve 221 – 226 të Kodit të Procedurës Penale (16), i cili jepet me vendim të organit kompetent të procedimit penal. Gjithashtu, ky ekzaminim realizohet edhe me mjete filmimi: kamera të llojeve të shumta që ndodhen në objekte të ndryshme private apo publike, në banesa apo zyra, në banka apo institucione që i mbajnë në punë në mënyrë të përhershme, të cilat aktualisht shfrytëzohen në të shumtën e rasteve nga organet e procedimit penal, për faktin se ka përhapje të gjerë të përdorimit të tyre. Incizimet e zërave të autorëve të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, në këto lloj aparatesh, mund të shfrytëzohen nga ekspertët e caktuar nga organi i procedimit për t'i pasur si objekt ekspertimi. Autorët që gjatë kryerjes së veprës penale komunikojnë nëpërmjet mjeteve të komunikimit ose direkt me njëritjetrin apo me të afërmit e personave të sekuestruar, ose me policinë, kur duan të bisedojnë apo kur paraqesin kërkesa në bisedë me ta për të bërë marrëveshje me lirin e ndonjë personi, apo për të evituar një akt terrorist që sjell dëm të madh të qytetarët, e lënë zërin e tyre të regjistruar në mjetet e komunikimit të bashkëbiseduesve të tyre, veç atyre që regjistrojnë në mënyrë automatike e të pavarur nga bashkëbiseduesit. Në këto raste, eksperteve u vihen në dispozicion këto incizime dhe identifikimi është rezultat i një ekspertimi me pajisje kompjuterike, në të cilat analizohet zëri nëpërmjet analizatorëve akustikë që e transkriptojnë zërin në diagram, shenjat e të cilit regjistrohen në ordinator. Duke qenë se zëri është i veçantë për çdo person, pikërisht për këtë ai përbën një «pasaportë akustike», e cila mund të shfrytëzohet me sukses, duke e krahasuar zërin e panjohur të regjistruar gjatë kryerjes së veprës, me zërin personave të dyshimtë, gjithashtu të regjistruar, sipas një studiuesi (17). “Zëri nuk humbet, nuk vidhet, nuk imitohet”, –shprehet një studiues tjetër (18). Pra, ka mundësi ekzaminimi dhe shërben në identifikimin e autorit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Kjo metodë përbën një ekzaminim e identifikim të saktë që na çon drejt zbulimit të autorit. Nëpërmjet këtij ekzaminimi përcaktohet: mosha, seksi, niveli kulturor dhe arsimor, gjendja emocionale e autorëve në momentin e kryerjes së veprës penale, numri i tyre, lëvizjet që kanë bërë në vendin e ngjarjes, objektet që kanë prekur, kanë spostuar, rrëzuar apo thyer. Këto na shërbejnë për të kryer ekzaminime të tjera, si: traseologjik, daktiloskopik, odorologjik, biologjik, të ADN-së, etj., për identifikimin e autorit/autorëve. Ky lloj ekspertimi, pra, identifikimi nëpërmjet zërit, ka gjetur përdorim në praktikën e organeve të hetimit paraprak dhe të gjyqimit.

Rastet e zbatimit, të marrjes dhe të ekzaminimit të kësaj prove në zbulimin e veprave penale të ndodhura, janë të shumta dhe kanë dhënë efektivitet në luftën kundër kriminalitetit. Ekspertët e caktuar nga organi i procedimit në kryerjen e këtij ekspertimi, e kryejnë atë në zbatim të kërkimeve të neneve: 149, 151, 179, 294, 300, 303, 314, 366 të Kodit të Procedurës Penale (19), duke i analizuar veç e veç diagramet e prodhuara pas analizës së zërit të administruar si provë dhe zërit të personit të dyshuar. Fizikani Lorenc G. Kresta, mbas shume studimesh dhe eksperimentesh,

arriti në përfundimin se saktësia e identifikimit të personit nëpërmjet zërit mundë të jetë në masën 99 – 65% (20). Në rast përputhjeje, personi i dyshuar identifikohet. Në rast mospërputhjeje, ai shfajësohet për akuzën e ngritur ndaj tij. Këtë mund ta ilustrojmë me rastin e parë të njohur në kriminalistikë për identifikimin e autorit të një vrasjeje nëpërmjet ekspertimit të zërit. Kjo ndodhi në San Pol të ShBA-së. Më 22 maj 1970, në mbrëmje, një grua telefoni në policinë e qytetit dhe kërkoi t'i dërgonin një makinë, mbasi po i lindte e motra shtatzënë dhe në shtëpi nuk kishin asnjë automjet transporti. Pas pak polici mbërriti në adresën e dhënë dhe, sapo trokiste në portën e shtëpisë, u godit në shpinë nga një predhë arme zjarri. Nisën hetimet e çështjes. Gjatë hetimit u provua se asnjëra nga banoret e asaj shtëpie nuk ishte duke lindur dhe asnjë prej tyre nuk kishte telefonuar në polici për automjet. Pra, telefonata kishte pasur qëllim që ta fuste policinë në kurth. Menjëherë filloi puna dhe u regjistrua zëri i secilit prej të dyshuarve. Nga krahasimi i programeve të përfituara, zëri i trembëdhjetë u identifikua si zëri i autores së thirrjes telefonike. Sipas ekzaminimit të bërë dhe përfundimit të dhënë, gruaja u arrestua dhe ky arrestim u realizua me anën e zërit. Por, pavarësisht nga rezultati i zbulimit të autorit të vrasjes së policit, kjo provë nuk mund të shërbente e vetme për gjykatën, por i shërbente hetimit paraprak për të ngritur versione dhe u akuzua për bashkëpunim në vrasje. Më pas gruaja tregoi bashkëpunëtorët dhe motivin e vrasjes. Gjatë shqyrtimit të çështjes në gjyq, krahas provave të tjera, u pranua edhe identifikimi në lidhje me autorin (21). Për identifikimin e tij, për të drejtuar hetimet paraprake drejt gjetjes së provave të tjera, që të vërtetohet akuza e ngritur ndaj autorit të dyshuar, mund të përdoret edhe kjo provë shkencore e marrë gjatë hetimit paraprak. Nga ana tjetër, gjykata, në dhënien e vendimit, e shqyrton edhe atë në raport me provat e tjera për të dhënë një vendim të drejtë e të bazuar. Edhe në Shqipëri, duke iu referuar praktikës së organeve të procedimit, kanë filluar identifikimet në bazë të zërit. Për herë të parë identifikimi i zërit të disa të akuzuarve nëpërmjet ekzaminimit të zërit të fiksuar në përgjimet telefonike mes tyre, të ne u realizua në vitin 2007 nga Qendra Shkencore e Mbrojtjes së Individit “The experts”, në një gjykim që zhvillohej nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë (22), për trafikim narkotikësh nga një grup i strukturuar kriminal. Pas këtij identifikimi, kjo qendër ka kryer dhe disa identifikime të tjera në bazë të zërit të autorëve të vënë nën procedim penal, në zbatim të kërkesave të gjykatave shqiptare.

Përfundime

Kryerja e këtyre ekspertimeve ka dhënë rezultate herë pozitive e herë negative, por gjithsesi, i kanë shërbyer dhe i shërben edhe sot dhënies së drejtësisë nga gjykatat. Përdorimi i këtyre ekspertimeve dhe të tjerave të këtij lloji, për vetë efektivitetin që japin në luftën kundër kriminalitetit, sidomos kundër atij të organizuar, trafikeve të ndryshme të armëve, kultivimit, transportit e shitjes së lëndëve narkotike të kategorive të ndryshme, kundër terrorizmit siç është dhe çështja penale kundër një grupi autorësh që së fundmi këtë vit po hetohet për prodhim e trafikim të narkotikëve me shtrirje të gjerë në Shqipëri e Itali, etj., është bërë si një domosdoshmëri për vërtetimin e kryerjes së këtyre veprave penale nga autorët e tyre, qofshin të vegjël apo peshq të mëdhenj. Kjo domosdoshmëri e përdorimit të tyre vjen edhe si rezultat i përdorimit të gjerë të regjistrimeve të zërit apo figurës me mjetet e sotme moderne të përdorimit privat e publik, e natyrisht, këto të fundit, me leje të organeve kompetente që ua jep këtë drejtë ligji, duke respektuar të drejtat kushtetuese të qytetarëve të parashikuara në Kreun II “Liritë dhe të drejtat vetjake” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ato të parashikuara në Kreun III “Mjetet e kërkimit të provës” (23), nenet 198 – 226 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë në hetimin

paraprak (24), e më pas në gjykimin nga gjykata të autorëve të veprave të ndryshme penale, e veçanërisht në ato të krimeve të rënda. Gjykatat, si organe që japin drejtësi, duhet të kenë në qendër të vëmendjes së tyre që në analizë të gjithë provave të shqyrtuara, veç e veç e në tërësi, edhe për faktet e përftuara e të verifikuara në shqyrtimin gjyqësor që kanë dalë nga ekspertimet, si dhe të atyre provave që vërtetojnë anën objektive e subjektive të veprës penale të paraqitura para saj nga organet e procedimit, duke kontrolluar zbatimin e drejtë të ligjit nga organet ligjzbatuese për dhënien e vendimeve sa më të drejta të mbështetura në prova ndaj të akuzuarve si autorë të veprave penale të caktuara.

Referenca

1. Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2005.
2. Arkivi i Institutit të Policisë Shkencore, Tiranë, 2002.
3. Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2002.
4. Kodi Penal i RSH, nenet 248, 301 Tiranë, 2017.
5. Arkivi i Prokurorisë Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. 1988, Tiranë, 2000.
6. Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 1994.
7. Latifi, V. Kriminalistika. Prishtinë, 2014, f. 41.
8. Veliqoti, L. Kriminalistika. Tiranë, 2015, f. 141.
9. Kodi i Procedurës Penale i RSH, nenet: 151, 184, 198 e 199, Tiranë, 2017.
10. Kodi i Procedurës Penale i RSH, neni 200, Tiranë, 2017.
11. Latifi, V. Kriminalistika, Prishtinë, 2014, f. 117.
12. Sanxhaku, A. & Marko, O. "Trajtimi, përgatitja dhe përdorimi qenve të shërbimit. Tiranë, 1984. f. 5.
13. Kliver, I. Socialisticeskaja zakonost, nr. 10, 1987.
14. Kodi i Procedurës Penale i RSH, neni 198/1, Tiranë, 2017.
15. Kodi i Procedurës Penale i RSH, neni 178, Tiranë, 2017.
16. Kodi i Procedurës Penale i RSH, neni 221 – 226, Tiranë 2017.
17. Veliqoti, L. Identifikimi i personit në bazë të zërit, Tiranë, 1998, f. 106.
18. Begeja, S. Kriminalistika, Vëllimi I. Tiranë, 2001, f. 72.
19. Kodi i Procedurës Penale i RSH, nenet 149, 151, 179, 294, 300, 303, 314, 366, Tiranë, 2017.
20. R. I. P. C Nr. 189/1965.
21. Myftarin, E. Identifikimi i personit nëpërmjet zërit . Revista Juridike nr. 52. Tiranë, 2005.
22. Arkivi i Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, 2007.
23. Kushtetuta e RSH, Kreu II "Liritë dhe të drejtat vetjake", Tiranë, 2016.
24. Kodi i Procedurës Penale i RSH Kreu III "Mjetet e kërkimit të provës", nenet 198 – 226, Tiranë, 2017.